



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:071614

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06227236

K.DH.SH.II.nr.1117/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Faton Bajrami Franciska Zhitija Ymeri, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “T.J.” B.I me seli ne Podujeve, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokat Halit Shaljani nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.433/22, të datës 08.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.09.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë e datës 28.02.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.433/22, i datës 08.01.2024, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “T.J.” B.I., me seli në Podujevë, kundër të paditurit Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural, II. Anulohet Vendimi Nr. Protokolli 2899 i datës 07.05.2020 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave i të paditurës i themeluar në kundërshtim me dispozitat ligjore administrative dhe çështja i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. III. Obligohet e paditura që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim. IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i të paditurit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës si e bazuar në ligj, të prishet aktgjykimi KA.nr.433/22 i datës 08.01.2024 duke vendosur meritorisht, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.

protokolli 2899 i datës 07.05.2020 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

Dhoma e Shkallës së Dytë shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin me nr.2899 të datës 07.05.2020 ka refuzuar ankesën e fermerit T.J., vendbanimi Balloc, Komuna Podujevë, masa 101.4, Prodhimi i qumështit nga lopët, si e pabazuar dhe e paargumentuar.

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në Gjykatë me datë 18.06.2020, kundër të paditurit MBPZHR-AZHB në Prishtinë, duke pretenduar se vendimi i tij është jo ligjor. Dhoma e Shkallës së Parë, për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, me datë 18.12.2023, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, si të bazuar, me arsyetim se Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar me nr. protokollin 2899 i datës 07.05.2020 i nxjerrë nga e paditura Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 07.05.2020 është marrë në përbërje të komisionit prej tre anëtarëve, me të cilin vendim komisioni e ka refuzuar ankesën e fermerit tani paditësit T.J. B.I., si të pa bazuar dhe të pa argumentuar me arsyetim se autorizimi i pagesës është bërë konform çmimorës së AZHB-së, raportit të kontrollit nga terreni dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2019 për Projektet e Zhvillimit Rural . Përbërja e Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave prej tre anëtarëve është në kundërshtim me Nenin 39 të UA MBPZHR nr. 16/19, ku përcaktohet Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave është një trup profesional për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen për ankesa, i cili përbëhet nga zyrtarë të AZHB-se dhe MBPZHR-se dhe themelohet me vendim të MBPZHR-së. Paragrafi 2 përcakton Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave përbehet nga pese (5) anëtarë, tre (3) prej të cilëve janë zyrtarë në AZHB, ndërsa dy (2) prej të cilëve janë zyrtarë në MBPZHR. Se paku njeri nga anëtarët e MBPZHR duhet të jete zyrtar nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural /Autoriteti Menaxhues. Ligji Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 23 parasheh detyrimin e organeve të administratës të vendimet t'i marrin në kuadër të kompetencës ligjore. Paragrafi 3 përcakton ushtrimi i kompetencës është i detyrueshëm. Përveç sa parashikohet në paragrafin 2 të nenit të këtij Ligji, organi publik apo palët nuk mund të përcaktojnë apo ndryshojnë atë me asnjë mjet. Përbërja e Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga pese (5) anëtarë, tre (3) prej të cilëve janë zyrtarë në AZHB, ndërsa dy (2) prej të cilëve janë zyrtarë në MBPZHR, e përcaktuar me Akt nënligjorë Nenin 39 të UA MBPZHR nr. 16/19, është e detyrueshme për marrjen e vendimit dhe organi administrativ nuk mund të ndryshoj përbërjen e komisionit. Si pasoj Komisioni në përbërje jo të plotë e në kundërshtim me dispozitat ligjore është jo kompetent për marrjen e vendimeve. Rrjedhimisht një vendim i marrë në përbërje jo të plotë në kundërshtim me kërkesat ligjore është jo kompetent dhe i kundërligjshëm. Neni 16, paragrafi 1.20 i LKA parasheh se Akti administrativ përfundimtar mund të kundërshtohet për shkak se akti është nxjerrë nga organi jo kompetent, ndërsa në bazë të Nenit 4 të LPPA-së parimi i ligjshmërisë i obligon Organet publike që në marrjen e vendimeve të veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Prandaj, në procedurë të rishqyrtimit obligohet e paditura, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanoj të metat e vendimit kontestues, në atë mënyrë që Ankesën e parashtruar nga paditësi "T.J." BI, përmes përfaqësuesit të autorizuar Halit Shaljami Avokat kundër vendimit me Nr. Ref. AZHB.07/4 202/2020 të datës 10.02.2020, dhe Njoftimit me nr. Ref.AZHB.07/4 202/2020 të datës 07.02.2020, ankesa me nr. ref: AZHB 07/4202/2020, ta shqyrtoj në përbërje të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të AZHB-së (MBPZGR), të formuar në përputhje me parimin e ligjshmërisë në përbërje të plotë siç parashihet me dispozitat ligjore të Nenit 39 të UA MBPZHR nr. 16/19.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, kolegji e vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm pasi që i njëjti është i bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e aprovon, se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të paditurës të ankimuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë, njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë i miraton si të drejta dhe ligjore.

Kolegji gjen se bazuar në provat e administruara nga Dhoma e Shkallës së Parë, është vendosur drejt dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe bazat ligjore në të cilat bazohet aktgjykimi për aprovimin e kërkesë padisë së paditëses, sepse pa dyshim vërtetohet se, e paditura nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore, kur komisioni që ka nxjerr vendimin e paditësit ka qenë i përbërë prej 3 anëtarëve, e jo siç është paraparë përcaktuar me akt nënligjor që Përbërja e Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga pese (5) anëtarë, tre (3) prej të cilëve janë zyrtar në AZHB, ndërsa dy (2) prej të cilëve janë zyrtarë në MBPZHR, e përcaktuar me Akt nënligjorë nenin 39 të UA MBPZHR nr. 16/19, është e detyrueshme për marrjen e vendimit dhe organi administrativ nuk mund të ndryshoj përbërjen e komisionit. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë ka vërtetuar se e paditura nuk ka vepruar drejtë me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit për përkrahje publike në masën 101.4 prodhimi i qumështit nga lopët.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave në këtë aktgjykim ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike pasi që e njëjta nuk i ka trajtuar të gjitha provat veç e veç, Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ndërsa sa i përket pretendimeve se Gjykata e Shkallës së Parë ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike duke marr parasysh se vendimi i atakuar në përbërje prej tre anëtarëve nuk paraqet shkelje ligjore marr për bazë nenin 34 paragrafi 14, 15 dhe 16 të UA nr.16/2019 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2019. Tutje ka deklaruar se gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale kur është thirrur në nenin 39 të Udhëzimit Administrativ nr.16/2019, për arsye se komisioni nga neni 39 ka mandat në një fazë tjetër të procedurës administrative, e jo pas vendimit të autorizimit të pagesës sipas nenit 34 paragrafi 14, 15 dhe 16 të UA nr.16/19 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillimin rural për vitin 2019. Këto pretendime të të paditurës kolegji i kësaj gjykate i konsideron në tërësi si të pabazuara, për arsye se neni 39 i UA

nr.16/2019 përcakton qartë kriteret për përbërjes se komisionit, për shqyrtim, vlerësim dhe vendosje në ankesë, e që në rastin konkret është dashur të vendoset për ankesën e paditësit T.J. B.I në lidhje me Masën 101.4 Prodhimi i qumështit nga lopët.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, andaj kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe drejtë ka zbatuar ligjin kur e anulon vendimin e atakuar me padi, sepse i njëjti nuk është i plotë dhe përmbajtjesorë për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 të LKA-së, dhe se i njëjti përmban të meta esenciale. Organi i paditur është dashtë që pas shqyrtimit të ankesës së paditësit të nxjerr aktvendim përmbajtjesorë, ashtu si parashihet me nenet 84, 85 dhe 86 të LPA-së, i cili aktvendim do të duhej t'i kishte në përmbajtjen e tij përmbledhjet faktike, bazën ligjore në të cilat bazohet akti. Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë që gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Kolegji vlerëson akti kontestues nuk është i plotë dhe përmbajtjesor për tu vlerësuar ligjshmëria e tij si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, ngase përmban të meta esenciale, që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë dhe nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. andaj duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata gjen se akti administrativ duhet të jetë në kuptim të nenit 47 dhe 48 të Ligjit për procedurën Administrative. Prandaj, në një gjendje të tillë të vlerësimit, sipas bindjes së kësaj gjykate e bën të pa qëndrueshëm arsyetimin e vendimit kontestues, ngase në arsyetim të vendimit të kontestuar është dashur të vlerësohen pretendimet e paditësit që kanë rëndësi vendimtare në mënyrë që të jepen sqarime bindëse.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës, nga shkak se e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar një gjendje të tillë të krijuar për mos mundësinë e vendosjes ashtu siç me dispozitat e neneve të lartcekura të LPA-së. Ngase akti administrativ, mund të kontestohet në konfliktin administrativ për shkaqe të paligjshmërisë formale dhe materiale. Shkaqet e paligjshmërisë formale juridike janë shkelja e rregullave të procedurës që konsistojnë edhe në të metat në formën e aktit dhe në mungesën e arsyetimit etj. Ndërsa nga vendimi i kontestuar nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike, ngase nuk janë ofruar prova të mjaftueshme dhe bindëse, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim në vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative. Kurse, sa i përket pretendimeve tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi sepse vlerësoi se janë të pabazuara dhe pa ndikim në vërtetimin e gjendjes faktike nga ajo e vetëtuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, për shkak se vendimi i kontestuar i të paditurës përmban të meta të tilla esenciale të lartcekura që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Andaj, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë..

Kolegji vlerëson gjykata e shkallës së parë përfundimin e tërë kësaj procedure e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në aprovimin e kërkesë-padisë. Gjykata e Komerciale e Kosovës vlerëson se mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Përfundimisht, Gjykata e Komerciale e Kosovës i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të

parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë gjendje të fakteve për shkak të metave të cekura si më lartë është anuluar Vendimi i të paditurit, dhe është obliguar në ri procedurë të veprj si në vështrim të nenit 65 të LKA-së, që pas administrimit të provave të nevojshme, e duke ju përmbajtur edhe vërejtjeve dhe sugjerimeve të gjykatës, të vendos në këtë çështje juridike, me vendim përmbajtjesor ashtu si parashihet me dispozitat e LPA-së, dhe ligjit material.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1117/24, me datë 30.09.2024

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari  
Ramush Bardiqi d.v.